



RAPORTI I MONITORIMIT PËR VITIN 2021

TË

DOKUMENTIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE  
PLANIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR  
TË MBETJEVE 2020-2035

## PERMBAJTJA

---

|  |    |
|--|----|
| SHKURTIME .....  | 4  |
| 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....  | 5  |
| 2. HYRJE .....   | 6  |
| 3. GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....  | 7  |
| 4. METODOLOGJIA E MONITORIMIT .....  | 7  |
| 5. REZULTATE TË MONITORIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR<br>TË MBETJEVE 2020-2035 ..... | 10 |
| 6. ANALIZË E DETAJUAR E PROGRESIT SIPAS TREGUESVE TË MONITORIMIT .....   | 19 |
| 7. PËRFUNDIME .....  | 62 |
| 8. SHTOJCA .....   | 63 |

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Dokumenti strategjik “Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit 2020-2035” (SKMIM) i miratuar në Maj 2020 përbën dokumentin kryesor të kuadrit të veprimeve për menaxhimin e mbetjeve në vendin tonë. Monitorimi i zbatimit të kësaj strategjie ndihmon në vlerësimin e efikasitetit të masave dhe hartimin e rekomandimeve për vijimin e punës në të ardhmen. Ky raport vlerësues mbulon vitin e dytë të zbatimit të SKMIM për vitin 2021.

Në vijim të mbështetjes së dhënë prej GIZ në kuadër të programit “Menaxhimi dhe riciklimi i mbetjeve të ngurta miqësor me mjedisin në Shqipëri”, procesi vlerësues ka mundur krijimin e një baze solide të dhënash rreth sektorit të menaxhimit të mbetjeve, të shoqëruar me ndërhyrje konkrete në disa zona pilote të vendit që synojnë të përmirësojnë cilësinë e shërbimit në nivelin vendor dhe konsolidojnë shkëmbimin e informacionit dhe saktësinë e të dhënave ndërmjet niveleve të qeverisjes.

Edhe gjatë vitit 2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka vijuar të jetë institucioni qendror përgjegjës për zbatimin e kësaj strategjie për të përmbushur objektivat e programit qeverisës së vendit. Përmes rolit të saj drejtues, MTM ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e kuadrit ligjor për sektorin dhe kordinuar punën dhe komunikimin ndërinstitucional.

Në procesin e vlerësimit të ecurisë së zbatimit të SKMIM për vitin 2021 janë përfshirë 82 institucione dhe agjenci në nivelin qendror dhe 61 Njësi të Qeverisjes Vendore. Të dhënat e grumbulluara gjatë periudhës Korrik – Nëntor 2022, kanë mundur krijimin e një tabloje relativisht të plotë të gjendjes së menaxhimit të mbetjeve në vendin tonë. Ajo përfshin të dhëna mbi menaxhimin e mbetjeve dhe informacione rreth proceseve të ndryshme ligjore, rregullatore, kualifikuese dhe ndërgjegjësuese në nivel qendror dhe vendor. Bazuar në të dhënat e grumbulluara prej mbi 74% të institucioneve (rreth 92% të institucioneve në nivel qendror dhe 56% të NjQV, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve).

Viti i dytë i zbatimit të SKMIM 2021 paraqet një ecuri progresive lidhur me zbatimin e masave të përcaktuara. Në nivel vendi trajtohen dhe përpunohen 70% e sasisë së gjeneruar të mbetjeve.

Sasia vjetore e gjeneruar e mbetjeve bashkiake është 888.018 Ton. Gjatë vitit 2021 në impiante rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve (landfill/incinerator) janë depozituar rreth 573 mijë Ton (ose 65% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin). Sasia e mbetjeve që depozitohen në impiante sanitare të cilat ofrojnë kushte të kontrolluara të grumbullimit të mbetjeve është rritur me rreth 40% brenda një viti (2021 kundrejt vitit 2020). Rreth 57 % e bashkive nuk i peshojnë mbetjet, ndërsa 43% i peshojnë mbetjet.

Raporti për vitin e dytë vendos një piketë në vlerësimin krahasues me vitin e parë, dhe nxjerrjen e rekomandimeve për ndryshime ose modifikime të treguesve të ecurisë për masa të veçanta. Për më tepër ai ndihmon në ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes për sektorin e menaxhimit të mbetjeve, një aspekt i nevojshëm edhe për procesin e negociatave me BE për integrimin evropian të vendit.

### 3. GJENDJA E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Edhe gjatë vitit 2021, menaxhimi i mbetjeve mbeti një ndër shqetësimet në tërë vendin. Lënia pas e një viti të vështirë të pandemisë Covid-19, mbarti problematika për nivelin vendor në shtrirjen e shërbimit apo përmirësimin e cilësisë së tij. Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka decentralizuar shumë shërbime publike nga niveli i qeverisjes qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore. Menaxhimi i mbetjeve është një përgjegjësi funksionale e qeverisjes vendore. Mbledhja dhe transporti ditor i mbetjeve dhe pastrimi i rrugëve duhet të organizohen në nivel vendor dhe përfituesit duhet të paguajnë për këtë shërbim në zbatim të parimit "prodhuesi pagan".

Reforma territoriale ishte një hap pozitiv për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Ai bëri të mundur një ekonomi të shkallës dhe një rritje të profesionalizmit të menaxhimit të mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve, pastrimi i rrugëve dhe transporti pjesërisht u zgjeruan dhe u përmirësuan, pasi këto shërbime janë më të dukshmet dhe më të pritshmet nga popullata.

Megjithatë, edhe me një numër më të vogël prej 61 njësisë të qeverisjes vendore, një pjesë e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve duhet të organizohen, operohen dhe financohen në nivel rajonal ose/dhe përmes strukturave rajonale: transporti, trajtimi dhe venddepozitimi. Po kështu, rehabilitimi i venddepozitimeve të vjetra, i cili përfaqëson një nga sfidat kryesore për mbrojtjen e ujit dhe ajrit, kërkon aftësi dhe burime financiare që kalojnë kapacitetet ekzistuese vendore.

Edhe viti 2021, pati zhvillime dhe nisma ligjore për të përmirësuar legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve, zbatimi i tij për këtë sektor mbetet ende një sfidë. Problemet e mbartura që u raportuan për vitin 2021 lidhen me shtrirjen e pjesshme të shërbimit në territor, grumbullimin dhe depozitimin jo të plotë të sasisë së gjeneruar të mbetjeve, numri i kufizuar dhe cilësia e dobët e pajisjeve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim dhe përqindja e ulët e riciklimit, mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve.




Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2021<sup>2</sup>, i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, referon se mbetjet e grumbulluara dhe përpunuara në total gjatë vitit 2021 vlerësohen në rreth 890,000 tonë. Në RGJM, raportohet se gjatë vitit 2021 grumbullimi, transferimi dhe trajtimi i mbetjeve vlerësohet se përfaqëson mbi 70% të gjenerimit të tyre në nivel bashkie. Raportohet se gjatë vitit 2021 në këto impiante rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve janë depozituar rreth 573 mijë Ton (ose 65% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin). Sasia e mbetjeve që depozitohen në impiante sanitare të cilat ofrojnë kushte të kontrolluara të grumbullimit të mbetjeve është rritur me rreth 40% brenda një viti (2021 kundrejt vitit 2020). Kjo rritje ka të bëjë me faktin se disa bashki i janë shtuar listës së atyre bashkive që grumbullojnë mbetjet në këto impiante si: Gramsh; Kurbin; Durres; Shijak; Vorë; Kamëz; Kavajë dhe Pogradec. Tirana është bashkia që raportohet të grumbullojë sasinë më të madhe të mbetjeve (292,147,000 Ton mbetje të ngurta urbane) ose afërsisht 33% të totalit të grumbulluar në nivel vendi.

Vetëm 26 bashki (ose 43%) peshojnë mbetjet e tyre të ngurta në pikën përfundimtare të depozitimit (landfill ose incinerator), por kjo shifër pritet të përmirësohet më tej në vitin 2022.

### 4. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Vlerësimi i ecursë në vitin e dytë të zbatimit të SKMIM dhe PKV 2020-2035 është bazuar në të njëjtën metodologji standarte të vlerësimit, si për vlerësimin e kryer për vitin e parë. Ai është bazuar bazuar në metodën krahasimore të rezultateve të grumbulluara për vitin 2021, si viti i dytë i zbatimit të



















<sup>2</sup> [https://akm.gov.al/ova\\_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2021/](https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2021/)








| 0-40%   | 40-70%  | 70-100%   |
|---|---|---|
| Përkeqësim i situatës, Mungesë progresi ose Ecuri e pakënaqshme                   | Ecuri sipas parashikimit  | Ecuri e kënaqshme ose shumë e mirë  |
|  |  |  |













Procesi i grumbullimit të të dhënave dhe ushtrimi validues i të dhënave të grumbulluara nga burime të ndryshme u mbështet tërësisht nga përfaqësues të MTM, programit të GIZ dhe pjesëtarë të agjencive të ndryshme pjesëmarrëse në Grupin Teknik të Ekspertëve.

Rezultatet e vlerësimit u paraqitën përpara grupit të ekspertëve gjatë muajit Nëntor 2022, ku u diskutuan edhe rekomandimet e përfshira në këtë vlerësim.









Raporti i Vlerësimit është hartuar në përputhje me Urdhërin e Ministrit të Turizmit dhe të Mjedisit për Miratimin e formatit të raportimit në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, i vitit 2022.

|   |   |   |   |
|---|---|---|---|
| <p>M4. Bashkitë mbulojnë gjithë territorin e tyre administrativ me shërbime që përmbushin standardet minimale të përcaktuara</p>  | <p>T5: % e mbulimit me shërbim e shprehur si numër eqv. banorësh që marrin shërbim / nr. eqv. të banorëve rezidentë</p>                 |    |    |
|   | <p>T6: % sasisë së mbetjeve të grumbulluara / sasia e mbetjeve të gjeneruara (sipas planifikimit)</p>                                   |    |    |
| <p>M5. Të gjitha Bashkitë e vendit kanë ndërtuar skemën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin më të mirë financiar dhe standardet minimale sektoriale sipas normave të direktivave përkatëse të transpozuar në ligjin shqiptar</p> | <p>T7: % e popullatës, mbuloheh me shërbimin e MIM.</p>   |    |    |
|   | <p>T8: % e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) mbuloheh me shërbimin e MIM</p>                           |    |    |
|   | <p>T9: % e sasisë së mbetjeve (për secilën rryme) që shkon për riciklim/sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në ton/vit</p>          |    |    |
|   | <p>T10: % e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbetjet mikse bashkiake kundrejt totalit të mbetjeve nga paketimi të rikuperueshme</p> |    |    |
|   | <p>T11: % e sasisë së mbetjeve të paketimit që rikuperohen në nivel bashkie kundrejt totalit të gjeneruar</p>                           |  |  |
|   | <p>T12: % e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill ose venddepozitime/ sasia totale e mbetjeve të grumbulluara ton/vit</p>       |  |  |
|   | <p>T13: Nr. i qendrave pritëse ose formate të tjera të ngritura nga bashkitë për</p>  |  |  |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>mbetjeje elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj</p>   | <p>T21: % e llumrave në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur trajtohen pranë impianteve</p>  |    |
| <p>M10. Ministria përgjegjëse për Mjedisin në bashkëpunim me institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për mbetjet, harton politika kombëtare që janë të aplikueshme në nivelin e Zonës së Mbetjeve dhe bashkie për një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të rrymave specifike në zbatim të hierarkisë së mbetjeve, për mbetjet bashkiake, jo bashkiake dhe mbetjet inerte nga ndërtimi dhe prishjet</p>                                  | <p>T22: % e mbetjeve inerte që grumbullohen kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren</p>  |    |
| <p>M11 Të gjitha bizneset që importojnë apo prodhojnë mbetje të rrymave specifike, në zbatim të parimit "të përgjegjshisë së zgjeruar të prodhuesit", ngrënë skemat e veçanta dhe/ose të përbashkëta në bashkëpunim me Bashkitë e vendit dhe përdorues të tjerë të mbetjeve specifike si për gomat, bateritë, mbetjeje elektrike dhe elektronike, mbetjet organike, makinat në fund të jetës, etj., për rikuperimin dhe trajtimin e tyre</p> | <p>T23: Kuadri ligjor, rregullator dhe standardet e shërbimit dhe të menaxhimit të mbetjeve specifike janë hartuar</p>                             |    |
| <p><b>QËLLIMI STRATEGJIK 2:</b> Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve</p>   | <p>T24: Numri i skemave funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike</p>   |    |
| <p><b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 4:</b> Kuadri ligjor i menaxhimit të mbetjeve është përmirësuar dhe harmonizuar me direktivat evropiane dhe është ngritur një sistem institucional efikas në nivel kombëtar</p>   | <p>T25: % e legjislacionit të rishikuar në zbatim të reformimit të parashikuar nga Dokumenti i Politikave Strategjike</p>                          |  |
| <p>M12 Autoritetet qendrore në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor kanë rishikuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve</p>  | <p>T26: % e legjislacionit të rishikuar për të ndarë qartësisht përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve</p> |  |
| <p>M13 Ligji ka parashikuar role dhe përgjegjësi institucionale të qarta për njësitë e qeverisjes qendrore dhe të qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, përfshirë edhe ato rajonale të cilat janë ngarkuar me funksione mbështetëse për menaxhimin e mbetjeve</p>  |  |  |

|  |  |   |   |
|--|--|---|---|
| <p>M18 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës kanalizimeve dhe Mbetjeve mbikëqyr dhe monitoron financat që lidhen me ndërtimin ose modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve</p>  | <p>T34: Buxheti i shtetit ka planifikuar dhe financon investimet për infrastrukturën e transportit dhe trajtimin të mbetjeve</p>   |    |    |
| <p>M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre</p> | <p>T36: MTM koordinon Fondin për Menaxhimin e Mbetjeve, nëpërmjet hartimit të kuadrit ligjor për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe vënien në zbatim të tij</p> |    |    |
| <p><b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 6:</b> Menaxhimi i mbetjeve është prioritet kombëtar dhe pjesë e rëndësishme e planifikimit të fondeve të ndihmës se huaj, IFI dhe BE nëpërmjet fondeve IPA</p>   |  |   |   |
| <p>M20. Qeveria e Shqipërisë alokon jo më pak se 10% të fondeve të saj vjetore, të dhuruara për menaxhimin e mbetjeve nga institucionet ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë</p>  | <p>T37: % e ndihmës së përfutur / kundrejt totalit të ndihmës së huaj</p>  |    |    |
| <p>M21. Është kryer planifikimi i detyruar dhe janë zhvilluar procedurat për hartimin dhe miratimin e projekteve në sektorin e menaxhimit të mbetjeve që kërkojnë financime publike dhe mbështetje nga donatorët</p>   | <p>T38: % e investimeve në sektor / kundrejt parashikimit vjetor sipas Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Master Planit</p>  |    |    |
| <p><b>QELLIMI STRATEGJIK 4:</b> Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve</p>  |  |   |   |
| <p><b>OBJEKTIVI STRATEGJIK 7:</b> Burimet njerëzore dhe pjesëmarrja</p>  |  |   |   |
| <p>M22. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve kanë përfshirë në strukturën e tyre njësitë e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve me personel të kualifikuar</p>  | <p>T.39: Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin</p>                                    |  |  |
| <p>M23. Krijohet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV dhe ASPA, së bashku me</p>  | <p>T.40: % e personelit të specializuar që trajnohet në vit</p>  |  |  |



| OBJEKTIVI STRATEGJIK 9: Janë identifikuar të gjitha rrymat e mbetjeve të rrezikshme që janë prodhuar apo prodhohen në territorin e vendit nga sektori publik dhe ai privat                |  |   |
|---|--|---|
| M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme) | T.48: % e institucioneve/bizneseve që gjenerojnë mbetje të rrezikshme që informojnë sipas kategorive dhe formatit të mbetjeve, të identifikuar |    |
| M29. Hartimi i Master Planit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme   | T.49: Plani kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme është hartuar   |    |
| M30. Janë hartuar dhe zbatohen udhëzimet, protokollet, standardet dhe programet e trajnimit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme   | T.50: % e mbetjeve minerare të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar                                  |    |
|   | T.51: % e mbetjeve kimikate të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar                                  |    |
|   | T.52: % e mbetjeve bujqësore dhe drurit të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar                      |    |
|   | T.53: % e mbetjeve nga gomat të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar                                 |   |
|   | T.54: % e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar    |  |
|   | T.55: % e mbetjeve nga llumi i impianteve të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar                    |  |

## 6. ANALIZË E DETAJUAR E PROGRESIT SIPAS TREGUESVE TË MONITORIMIT

Kjo pjesë e Raportit të Vlerësimit për vitin e dytë të zbatimit të SKMIM paraqitet ecurinë në zbatimin e SKMIM 2020-2035 sipas Masave dhe treguesve përkatës. Të dhënat e grumbulluara sipas metodikës së monitorimit kanë mundësuar formimin e opinionit vlerësues në aspektin sasior dhe/ose cilësor.

**QËLLIMI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE DUKE PËRMBUSHUR PARIMET KRYESORE DHE KËRKESAT LIGJORE TË PLANIFIKIMIT.**

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE BËHET NË BAZË TË ZONAVE TË MBETJEVE DUKE OFRUAR SHËRBBIM PËR TË GJITHË POPULLATËN**

**M1. Ngritja e sistemit të dokumentimit, informimit dhe performancës të statistikave të gjenerimit, transferimit dhe trajtimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe vendor**

Nga 34 Bashki (ose 55.7 % të totalit) i janë përgjigjur pyetësorit duke referuar se vetëm 18 Bashki (52.9% të përgjigjeve ose 29.5% e totalit) i janë përgjigjur pyetësorit duke referuar se vetëm 14 Bashki (37.8% të përgjigjeve ose 23% e totalit) kanë ngritur sistemin e grumbullimit të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor dhe referimin e tyre në sistemin kombëtar të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve.

Krahasuar me vitin e parë 2020, gjatë 2021 vërehet një rritje me 6.5% të numrit të bashkive që referojnë ngritjen e sistemit në nivelin vendor. Bashkitë që kanë sistem të grumbullimit të të dhënave dhe infrastrukturën fundore (26 bashki ose 42.6% të totalit) bazohen në të dhënat prej peshimit në impjantet fundore të trajtimit, ndërsa pjesa e mbetur prej 57.4% bazohen në të dhënat e grumbulluara prej strukturave në NjQV. Pothuaj të gjitha Bashkitë referojnë problematike të dhënat sipas rrymave të mbetjeve për shkak të mos ndarjes së mbetjeve në burim.

Ndërkohë AKM, në Raportin për Gjendjen e Mjedisit 2021, raporton se 59 Bashki deklarojnë të dhënat mbi sasinë e grumbulluara të mbetjeve. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", NjQV kanë detyrimin të dorëzojnë të dhënat mbi rrymat e mbetjeve të gjeneruara në territorin që ato administrojnë deri më 31 Janar të çdo viti.

Bazuar në të dhënat e RGM 2021, (Aneksi III) për 9 zona të mbetjeve ka të dhëna të pjesshme lidhur me rrymat e mbetjeve, bazuar në vetëdeklarimin e bashkive, por mungojnë të dhënat për bashkitë e veçanta. Sipas të dhënave të AKUM për vitin 2021, 40 bashki (ose 66% e totalit) e kanë sistemin e informacionit dhe deklarojnë të dhëna për rrymat e mbetjeve.

Për vitin 2021 referohet prej agjencive të donatorëve se të gjitha zonate mbetjeje janë mbuluar me studimet e Fizibilitetit. Raportohet se janë në proces studimet e fizibilitetit për 4 zona të mbetjeje dhe kanë përfunduar hartimi për zonat e mbetjeje të Beratit, Kukës, Gjirokastër dhe Vlorë-Jug, Fier dhe Elbasan.

Për vitin 2021 informacioni lidhur me financimin e projekteve në zbatim për menaxhimin e integruar të mbetjeje është shumë i kufizuar. Nga buxheti i shtetit, për sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeje u planifikuan rreth 5.5 Mld Lekë ose dhe u realizuan rreth 4.14 Miliardë lekë ose 16% më shumë sesa viti 2020.

Krahasuar me vitin 2020 (vitin e parë të zbatimit të SKMIM), buxheti publik për vitin 2021 ishte 2.7 Miliardë Lekë më i madh (2.9 Mld Lekë për 2020), por niveli i realizimit mbetet pothuaj i pandryshuar (74% ne 2021 nga 76% në vitin 2020).

Duke vlerësuar të dhënat e SKMIM për financimet në menaxhimin e mbetjeje në periudhën 2011-2019, vërejmë se financimi i brendshëm i realizuar për këto vite ka qenë 11.76 Mld Lekë. Ndërkohë, me fillimin e zbatimit të SKMIM vetëm në dy vitet e para 2020-2021, planifikimi i financimit të brendshëm është në masën 8 Miliardë Lekë. Peshën kryesore në financimin e brendshëm e zënë investimet në sistemet përfundimtare të përpunimit të mbetjeje dhe kryesisht për inceneratorët në Fier dhe Tiranë.

Mungon informacioni lidhur me kontributin e donatorëve të huaj për financimin e projekteve në zbatim të masave të SKMIM.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se kishte asnjë studim fizibilitetit për zonat e mbetjeje, kundrejt 8 për t'u përfunduar deri në vitin 2025, vërejmë se ka progres në përmbushjen e objektivit për këtë masë.

| Treguesi nr. 2-3  | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020   | Realizimi 2021   | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor |
|---|-----------|----------------|------------------|------------------|---|-------------------|
| Numri i studimeve të fizibilitetit për zonat e mbetjeje | 0         | 8              | 4 (+2 në proces) | 6 (+4 në proces) | 75% (+25% ▲ me 2020)                            | 😊                 |
| % e projekteve të Materplanit të financuara             | 0         | 20%            | 3                | Nuk ka të dhëna  | E pamundur për vlerësim sasior                  | 😐                 |


**Rekomandim:** Ecuria e deritanishme dhe të kuptuarit se mbulimi me Studime të Fizibilitetit për të gjitha zonat e mbetjeje është domosdoshmëri për ndërmarrjen e masave dhe të investimeve konkrete, Objektivi për vitin 2025 duhet të ndryshojë në masën 100%, pra mbulim i plotë me studime të fizibilitetit për të gjitha zonat e mbetjeje.

Bashkitë që kanë vetëdeklaruar se kanë PVMIM shprehen se ndeshin vështirësi në zbatimin e tij. Disa bashki referojnë se realizojnë një zbatim të pjesshëm të tij (Peqin 50%, Dibër 58%) për shkak të mangësive në burime njerëzore, financiare dhe mjete. Problematikë e mprehtë mbetet hedhja ilegale e mbetjeve në territor. Disa bashki referojnë se PVMIM ka qenë shtysë pozitive për përmirësimin e shërbimit. Kështu Bashkia Fushë Arrëz referon zgjerim të shërbimit në Njësinë Administrative Qafë Mali, ndërsa Bashkia Malësi e Madhe referon përmirësim të cilësisë së shërbimit në grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve.

Nga ana tjetër bashkitë që kanë referuar mungesën e PVMIM shprehen se kanë qenë pengesa teknike dhe procedurale si për shembull Bashkia Përmet ka paraqitur probleme lidhur me konsultimin publik të dokumentit për mungesë interesimi të komunitetit. Bashkia Vlorë është në fazën e miratimit të PVMIM në Këshillin Bashkiak.


#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar vitit 2019 si vit krahasimor ku referohet se kishte vetëm 15 bashki kishin PVMIM, kundrejt 30 për t'u përfunduar deri në vitin 2025, vërejmë se ka progres në përmbushjen e objektivit për këtë masë.

| Treguesi<br>nr.4                                | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>vitin 2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|---|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| +Numri i bashkive që kanë një PVMIM të miratuar | 15           | 30                | 27                | 30                | 100 %  |  |

**Rekomandim:** Kërkesa për një PVMIM lind prej nevojës për menaxhimin efektiv të burimeve të kufizuara për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor. Për më tej, çdo investim në këtë sektor do të kërkojë planifikimin e kujdesshëm vendor. Për këtë arsye, gjatë rishikimit të strategjisë, treguesi për këtë masë duhet të ndryshojë në 100% deri në vitin 2025. Një objektivi i tillë është plotësisht i arritshëm në kohë dhe me burimet e disponueshme prej çdo NjQV.

Vetëdeklarimi i bashkive lidhur me përmirësimin e gjendjes në menaxhimin e mbetjeve tregon perceptimin pozitiv me një ndryshim rritës prej 5.5 pikë përqindjeje të numrit bashkive. Megjithatë duhet të vënë në dukje se kampioni i përgjigjeve për vitin 2021 është i barabartë me 73% e atij të vitit pararendës.



**Grafiku 4:** Vlerësimi krahasimor lidhur me ndryshimin e gjendjes së menaxhimit të mbetjeve ndërmjet dy viteve të monitorimit

Vlerësimi specifik lidhur përmirësimin e gjendjes për menaxhimin e mbetjeve argumentohet me zgjerimin e hapësirës së mbuluar me shërbim në zonat rurale. Në disa bashki ilustrohet me rritjen e cilësisë së shërbimit: për shembull në Bashkinë Rrogozhinë cilësohet përmirësimi i infrastrukturës, kurse në atë Roskovec dhe Durrës referohet se është rritur shpeshësia e tërheqjes së mbetjeve.

Të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbetjeve i referohen RGJM 2021, ku për vitin 2021 janë grumbulluar 888.018.325 ton mbetje, e cila është 5.6% më e lartë se sasia e raportuar e mbetjeve të grumbulluara për vitin 2020 (856.738.562 ton mbetje), krahasuar me 792, 520 ton të grumbulluar në vitin 2019.

Ndërkohë, AKUM raporton sasinë prej 847.603.000 ton mbetje për vitin 2021 të grumbulluar në nivelin e bashkive (ose 95.5% të sasisë së llogaritur në RGJM 2021). Krahasimi ndërmjet shifrave të raportuara nga këto dy agjenci është shumë më i përafërt për vitin 2021, krahasuar me 2020 (ku sasia e raportuar prej AKUM ishte sa 77% e shifrës së raportuar në RGJM 2020). Ky rezultat i përmirësuar mund të jetë një tregues i funksionimit të sistemit të informacionit, ndonëse i pjesshëm.

Edhe për vitin 2021, Bashkitë nuk kanë raportuar pranë AKM mbi sasinë e gjeneruar të mbetjeve, por vetëm sasinë e grumbulluar të tyre. Vendin e parë për sasinë e grumbulluar ndër Qarqet e vendit e zë Tirana (367.721 mijë me një rritje prej +7.6% krahasuar me 2020), Vlora (93978 mijë ton mbetje me një rritje 24.4% krahasuar me 2020) Fieri (89526 mijë ton mbetje me rënie prej 24.6% krahasuar me 2020), ndërkohë që sasinë më të vogël e prodhon Qarku i Gjirokastrës (14.131 mijë ton mbetje me një rënie prej 27% krahasuar me vitin 2021). Me mbështetjen e projektit të Agjencisë Gjermane për Zhvillim (GIZ) është bërë ushtrimi i peshimit të sasisë së mbetjeve në 45 bashki të vendit, ndërkohë që vetëm 16 bashki nuk i peshojnë ende mbetjet e tyre në pikat fundore të trajtimit të mbetjeve. Gjatë vitit 2021, numri i bashkive

**Rekomandim:** Ndonëse ka përmirësim në të dhënat e raportuara prej Agjencive të ndryshme, të dhënat e mbulimit me shërbim për popullësinë paraqesin mospërputhshmëritë më të mëdha. Saktësimi i numrit të banorëve për NjQV do të ndihmojë në matjen e saktë të indikatorit përkatës dhe të llogaritjes së sasisë së mbetjeve për çdo banor.

**Rekomandim:** Të rishikohen objektivat e SKMIM lidhur me treguesit, meqë objektivi për vitin 2025 në masën 70% vlerësohet i ulët dhe i pajustificuar. Synimi duhet të jetë arritja sa më e shpejtë e grumbullimit të 100% të mbetjeve të gjeneruara në nivel vendi, në mënyrë që të shmanget ndotja e mjedisit (ujrave dhe tokës) prej shpërndarjes së tyre në territor.

**M5. Të gjitha Bashkitë e vendit kanë ndërtuar skemën e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin më të mirë financiare dhe standardet minimale sektoriale sipas normave të direktivave përkatëse të transpozuar në ligjin shqiptar**

Kuptimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve vijon të jetë ende një koncept i thjeshtëzuar, në grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve në impiantin fundor të përpunimit të tyre. Vetëm 5 bashki (nga 34 të përfshira në monitorim gjatë 2021) referojnë saktë se kanë ngritur sistemin MIM. Nga ana tjetër, 29 bashki (apo 86% e bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit të monitorimit) referojnë se kryejnë MIM dhe pjesa tjetër deklarojnë se ky shërbim nuk ofrohet ende, por përgjigjet vlerësohen me mangësi apo të pasakta për arsye të mos dhënies së informacionit faktik për sasi të mbetjeve sipas rrymave. Të dhënat kontradiktore lidhur me ngritjen ose funksionimin e sistemit MIM tregojnë se ka paqartësi në nivelin e bashkive lidhur me zbatimin e standardeve të MIM.

Viti 2021 nuk ka sjellë ndryshim të dukshëm ose të referuar lidhur me ndarjen e diferencuar të mbetjeve në burim. Ndarja në burim mbetet vetëm në fazë pilotimi në zona të kufizuara urbane, pa mundur të krijojë fluksin e rrymave të mbetjeve që në këtë fazë të grumbullimit. Sipas të dhënave të grumbulluara nga plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit për këtë vit, vetëm Bashkia Korçë (2.3%) dhe Kolonjë (10%) referojnë sasi të grumbulluara që shkojnë për riciklim. Asnjë bashki nuk referon zhvillime pozitive lidhur me ndarjen në burim.

Sipas AKUM, të dhënat për sasi të gjeneruara të mbetjeve sipas rrymave për 40 bashki (nga 61 bashkitë e vendit) nuk referohen nëse i përkasin ndarjes në burim apo ndarjes në pikat fundore të trajtimit.

Sipas RGJM 2021 (Shtojca III), për 12 qarqet, për rrymat kryesore të mbetjeve ku referohen sasi të grumbulluara, sërish nuk ka referencë për sasi të grumbulluara prej ndarjes në burim.

Ndërkohë, sipas RGJM 2021 raporton se janë depozituar rreth 573.226 mijë ton (ose 65% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin) në impiantet rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve. Kjo shifër është 144.757 mijë ton më e lartë se një vit më parë (ose sa 25% e totalit për vitin 2021). Pjesa e mbetur e mbetjeve (rreth 35% e sasisë së përgjithshme) vlerësohet se hidhet në mënyrë të pakontrolluar në vend depozitime bashkiake të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale sanitare të përcaktuar nga ligji.

Pyetësori i vlerësimit prej bashkive, nuk jep të dhëna mbi sasi të ricikluara në nivelin vendor prej kompanive të riciklimit.

Të dhënat e marra prej AKUM për vitin 2021 japin shifrën prej 35.459 ton mbetje të ricikluar (ose 4%) të sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara gjatë këtij viti. Bashkitë që referojnë sasi mbetjesh të ricikluara në ton mbetje janë:

Lezha (3.4), Hasi (285), Rrogozhina (5108), Peshkopia (53), Elbasani (23316), Korça (700), Erseka (186), Berat (900), Vlorë (4850), Sarandë (22), Tepelenë (35).

Nuk ka të dhëna të ndara mbi sasi të ricikluara sipas tipologjisë së materialeve që shkojnë për riciklim. Mangësia e të dhënave për këtë tregues vërehet edhe lidhur me treguesin e rikuperimit të mbetjeve prej paketimit. Nga RGJM 2021, në katalogun e mbetjeve referohet se nga mbetjet prej paketimeve janë rikuperuar: 544 498 ton letër; 26 383 tonë plastikë; 14 270 tonë qelq dhe 125 tonë metale. Në bashkitë ku kanë filluar zbatimin projekte pilote për rikuperimin (Sarandë, Himarë, Cërrik) janë mbledhur edhe të dhënat e para, të cilat do të jenë të plota në vitet pas ardhëse.

Bashkitë referojnë 7 qendra pritëse për inertet (Berat, Korçë, Kurbin, Dibër, Lushnjë, Dropull, Përmet), ndërkohë që nga AKM referohet se nuk ka asnjë leje mjedisore të dhënë për vitin 2021 për të tilla qendra. Një shifër e tillë mund të referohet kur qendra është pjesë e ladhfillleve ekzistuese dhe operojnë brenda tyre

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Për vitin 2021 vijon tendenca e rritjes së sasisë së mbetjeve që depozitohet në stacionet përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, duke pasur kontributin më të lartë në depozitimet që kryhen në landfillet sanitare, ndërsa trajtimi në inceneratorë nuk ka pasur ndryshim.

Nuk vërehet progres lidhur me rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve sipas rrymave të ndryshme.

| Treguesit nr. 7-14   | Viti i referencës 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020     | Realizimi 2021                       | Vlerësimi për vitin 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor   |
|--|------------------------|----------------|--------------------|--------------------------------------|---|---|
| % e popullatës, mbulohen me shërbimin e MIM.                           | 15%                    | 30%            | Mungojnë të dhënat | Bashkitë Sarandë Himarë Cërrik<br>3% | Progres i kufizuar                                    |  |
| % e popullatës në qytete me më shumë se 100,000 banorë, (zonat urbane) | 10%                    | 35%            | Mungojnë të dhënat | Mungojnë të dhënat                   | Ska progres   |  |

|  |  |                                    |   |   |                |   |
|--|--|------------------------------------|---|---|----------------|---|
| tjera të ngritura nga bashkitë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga prishjet dhe ndërtimet       |  |                                    |   |   |                |   |
| Numri i sistemeve të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngritura në zbatim të hierarkisë së mbetjeve | 5 (landfill Bajkaj/Saran dë, Maliq/Korçë, Bushat/Shkodër, Sharrë/Tiranë, ËtE Elbasan | 8 (landfill Vlorë, Berat, ËtE Fier | 5 sisteme funksionale dhe 2 sisteme në proces | 5 sisteme funksionale dhe 3 sisteme në proces | Nuk ka progres |  |

**M6. Në të gjithë territorin janë trajtuar dhe mbyllur sipas udhëzimeve në fuqi të gjitha vend-depozitimet bashkiake historike të mbetjeve.**

Gjatë vitit 2018, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kryer monitorimin të të gjithë territorit, në të cilin ka identifikuar 199 vend depozitime historike. Për vitin 2021, nga Bashkitë referohen se janë në proces 7 venddepozitime, dhe ndërkohë janë mbyllur ose rehabilituar 37 venddepozitime. Nga 34 Bashkitë që janë përgjegjur në pyetësor referohet se janë ende pa ndërhyrje rehabilituese apo përmirësuese edhe 22 venddepozitime të mbetura.

Nga vlerësimi kumulativ i viteve paraardhëse del se është ndërhyrë në rreth 75% të venddepozitimeve (ose rreth 145 prej tyre). Shkalla e ndërhyrjes është e papërcaktuar. Pjesa më e madhe e bashkive janë përgjegjur për vështirësi financiare lidhur me realizimin e punimeve ndërhyrëse afatgjata.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:**

Referuar objektivit të vitit 2025, vërehet se vijon procesi i adresimit të problemit të trashëguar për mbylljen e venddepozitimeve historike. Mungesa e financimeve dhe e gjetjes së zgjidhjeve afatgjata për stacionet përfundimtare të trajtimit të mbetjeve kufizojnë Bashkitë të hartojnë dhe zbatojnë projekte rehabilituese dhe mbylljen përfundimtare të tyre.

| Treguesi nr. 15   | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021                              | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025       | Vlerësimi cilësor   |
|---|-----------|----------------|----------------|---|---|---|
| Numri i venddepozitimeve historike të trajtuara dhe/ose mbyllura kundrejt numrit total të | 0         | 30             | 3              | 37 mbyllur ose trajtuar<br>+<br>7 në proces | 75% e venddepozitimeve të identifikuara në vitin 2018 |  |



**M 8. Skema kombëtare e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit zbatohet për paketimet dhe mbetjet nga paketimi**



Në informacionin e grumbulluar prej Ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore lidhur me këtë masë, referohet se edhe gjatë vitit 2021, nuk është ndërmarrë asnjë nismë ligjore ose rregullatore për të vënë në zbatim skemën kombëtare të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesve (PZP).

Në kuadër të ndimës së huaj, MTM ka filluar hartimin e kuadrit ligjor përkatës, i cili pritet të miratohet gjatë vitit të ardhshëm dhe fillojë zbatimin e skemave të PZP.

Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:

Referuar objektivit të vitit 2025 për të grumbulluar 25% të mbetjeve nga paketimet në skemën PZP, vlerësohet se duhet adresuar me prioritet gjatë vitit 2021 e në vijim, për të arritur objektivin e vendosur për vitin 2025.

| Treguesi<br>nr. 18   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| % e mbetjeve nga paketimet të grumbulluar nga skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit | Nuk ka       | 25%               | Nuk ka            | Nuk ka            | Nuk ka<br>progres  |  |

|   |        |     |                 |     |                        |   |
|---|--------|-----|-----------------|-----|------------------------|---|
| % e llumrave në impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur trajtohen pranë impianteve | 5%     | 30% | Nuk ka të dhëna | 0%* | Nuk mund të vlerësohet |  |
| % e mbetjeve inerte që grumbullohen kalojnë në impiantet e trajtimit dhe ripërdoren     | Nuk ka | 30% | 0               | 0   | Nuk ka progres         |  |


\* Trajtimi kryhet pranë impjanteve të trajtimit të ujrave të ndotur

**Rekomandim:** Lidhur me këto rryma mbetjesh të grumbullohet informacion faktik mbi procesin e përpunimit të tyre sipas indikatorëve, në shtesë të dhënave të mbledhura për sasi të gjeneruara dhe të grumbulluara.


Gjate vitit 2021, bashkitë mbledhin mbetje organike në një pjesë shumë të madhe të mbetjeve të përgjithshme, sasia e të cilave varion nga 55% deri në 70% të mbetjeve të përgjithshme të grumbulluara.

Ka filluar funksionimi i skemës së trajtimit të mbetjeve organike në Cërrik dhe përgatitur për operim edhe dy qendra të tjera. Po kështu gjatë 2021, filloi operimin qendra e grumbullimit në Sarandë për grumbullimin e letrës, kartonit, plastikës dhe metaleve.

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

| Treguesi<br>nr. 24   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020                         | Realizimi<br>2021  | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|---|--|--|---|
| Numri i skemave funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike | 0            | Jo më pak se 5    | Fillimi i punës në katër nisma kompostimi | 2 skema funksionale në Cërrik dhe Sarandë<br><br>Në proces 2 skema | Ka progres të kufizuar                                   |  |

**Rekomandim:** Nën shembullin e modeleve të krijuara për skemat e mbetjeve organike dhe të grumbullimit të rrymave të riciklueshme në bashkitë pilote, të vijojë mbështetja e skemave të tilla edhe në bashkitë e tjera të vendit dhe nxitja e skemave të ngjashme edhe për rryma të tjera mbetjesh.

| Treguesi nr. 26  | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020                        | Realizimi 2021 | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor   |
|--|-----------|----------------|---------------------------------------|----------------|---|---|
| % e legjislacionit të rishikuar për të ndarë qartësisht përgjegjësitë dhe rolet e institucioneve të përfshira në menaxhimin e mbetjeve | 50%       | 100%           | 3 akte ligjore + dokumenti i analizës | 0              | Nuk ka progres                                  |  |

#### M14 Nevoja e rivlerësimit për të siguruar një sistem të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve


Edhe gjatë vitit të zbatimit të SKMIM (2021), bazuar në deklaratimet e MTM dhe të agjencive që kanë raportuar, nuk është kryer vlerësim (ose rivlerësim) i sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Në nivelin vendor, 7 Bashki (nga 34 që i janë përgjigjur pyetësorit për monitorimin e zbatimit të SKMIM në vitin e dytë) kanë kryer vlerësim të planit të tyre vendor për mbetjet. Bashkitë Mat dhe Vlorë referojnë se vlerësimi në nivel vendor janë të lidhura me hartimin e Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve. Bashkitë e tjera që kanë referuar rivlerësime nuk japin informacione shtesë mbi arsyet e këtyre proceseve apo rreth ndryshimeve të kanë sjellë lidhur me Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

|  |   |
|--|---|
| Bashkitë që raportojnë se kanë kryer rivlerësime në nivel vendor | Dropull, Rrogozhinë, Kavajë, Kolonjë, Korçë, Mat, Vlorë |
|--|---|

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Bazuar në informacionin e grumbulluar për treguesin e PVMIM, ku ka paqartësi në kuptimin e kuadrit të MIM, progresi i hartimit të dokumentave vendorë të lidhur me MIM, edhe përmes proceseve rivlerësuese është shumë i kufizuar. Vlerësimet e kryera në shumicën e bashkive mbështeten nga programet e asistencës së huaj në Shqipëri.

| Treguesi nr. 27  | Viti 2019          | Objektivi 2025 | Realizimi 2020  | Realizimi 2021  | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor   |
|--|--------------------|----------------|-----------------|-----------------|---|---|
| Kryerja e vlerësimit për riorganizimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve | Rishikuar sipas MP | Në zbatim      | Nuk është kryer | Nuk është kryer | Nuk ka progres                                  |  |

#### M15 Bashkitë miratojnë rregulloret e menaxhimit të integruar, në përputhje me udhëzimet e nxjerra.

Vetëm 10 bashki (nga 34 që janë përgjigjur për Monitorimin e Strategjisë për vitin e dytë 2021) deklarojnë se kanë rregullore në nivelin vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Megjithatë, asnjë nga këto bashki nuk referon hartimin dhe miratimin e ndonjë dokumenti në nivel vendor. Tre nga bashkitë referojnë se kanë miratuar një rregullore të tillë në vitin 2022.

**QELIMI STRATEGJIK 3: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I MENAXHIMIT TË MBETJEVE**

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 5: BURIMET FINANCIARE PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE PARASHIKOHEN NË PLANIFIKIMIN BUXHETOR AFATMESËM TË MIRATUAR ME LIGJ**

**M16/1: Strukturat përgjegjëse për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përgatisin udhëzuesin për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimet bashkiake të mbetjeve të ngurta.**

Nga veprimtaritë e realizuara në vitet paraardhëse kjo masë quhet e realizuar meqë udhëzuesi për llogaritjen e kostos për menaxhimin e mbetjeve i miratuar në 2018. Ky udhëzues mundëson Bashkitë të vlerësojnë të gjithë infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe mjetet financiare të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Vënia në zbatim në nivelin vendor mundëson edhe vlerësimin e nevojës për financim në nivel kombëtar dhe për çdo ZMM. Treguesi i përshkruar në dokumentin e SKMIM paraqet përqindjen totale e financimit të Dokumentit të Politikave Strategjike nga buxheti i brendshëm (PBA) / kundrejt nevojës për financim në nivelin e ZMM për fazë (transferim dhe trajtim).

Gjatë vitit 2021, për sektorin e menaxhimit të integruar të mbetjeve u planifikuan rreth 5.5 Miliardë Lekë ose dhe u realizuan rreth 4.14 Miliardë Lekë ose 16% më shumë sesa viti 2020. Buxheti publik për mbetjet u realizua në masën 76% të planit.

| Financime për menaxhimin e mbetjeve (fonde buxhetore alokuar dhe planifikuar nga Bashkitë) (në miliardë Lekë) | 2019                       | 2020                       | 2021                     | 2022   |
|---|----------------------------|----------------------------|--------------------------|--------|
| Buxheti (në miliardë Lekë)  | 2.21                       | 4.72                       | 5.47                     | 9.10   |
| Realizimi (në miliardë Lekë)<br>(% kundrejt buxhetit të miratuar)   | 1.71<br>(77.4% e buxhetit) | 3.79<br>(80.3% e buxhetit) | 4.14<br>(76% e buxhetit) | 5.00*) |
| Trendi vjetor i plan buxhetit (në %)  | 100%                       | 122%                       | 16%                      | 30%    |

\*) realizimi për vitin 2022 është vetëm për 10 muaj e parë. Burimi informacionit Drejtoria e Thesarit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Duke vlerësuar të dhënat e SKMIM për financimet në menaxhimin e mbetjeve në periudhën 2011-2019, vërejmë se financimi i brendshëm i realizuar për këto vite ka qenë 11.76 Mld Lekë. Ndërkohë, me fillimin e zbatimit të SKMIM vetëm në dy vitet e para 2020-2021, planifikimi i Financimit të brendshëm është në masën 8 Mld Lekë. Peshën kryesore në financimin e brendshëm e zënë investimet në sistemet përfundimtare të përpunimit të mbetjeve dhe kryesisht për inceneratorët në Fier dhe Tiranë.

|  |  |                      |                      |
|--|--|----------------------|----------------------|
| Qarku Vlorë  | Punime shtesë të impiantit të trajtimit të ujerave dhe shtresave të landfillit Bajkaj  | 27,200,000           | 27,200,000           |
| Qarku Vlorë  | Supervizion punimesh për objektin: Punime shtesë të impiantit të trajtimit të ujerave dhe shtresave të landfillit Bajkaj     | 530,000              | 475,669              |
| Shoqata Rajonale e Menaxhimit të Mbetjeve Korçe                            | TVSH për projektin Administrimi i mbetjeve të ngruta në Juglindje të Shqipërisë, masa shoqëruese, faza e dytë (rajoni Korçë) | 9,100,000            | 5,763,734            |
| Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve | TVSH për "Menaxhimi i mbetjeve të ngruta në Qarkun Vlorë"  | 243,900,000          | 159,669,294          |
| Aparati MIE  | TVSh e detyrim doganor Sistemi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit  | 34,000,000           | 30,966,427           |
|  | <b>Totali Lekë</b>   | <b>1,888,078,000</b> | <b>1,724,635,943</b> |
|  | <b>Realizimi në 31 Dhjetor 2021</b>  |                      | <b>91%</b>           |

Edhë gjatë vitit 2021, për shkak të pamundësisë së pushtetit vendor për të mbuluar financiarisht investime të tilla të mëdha, qeverisja qendrore i ka konsideruar strategjike dhe i ka mbuluar nga buxheti i shtetit.

Financimi i sektorit MIM nga të gjitha burimet e financimit (QQ+NjV+Donatorë) gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

| <b>Financimi total i sektorit MIM (QQ + QV + Donatorë)</b> | <b>2021 Fakt<br/>(në Milionë Lekë)</b> | <b>2021 Fakt<br/>(në Milionë EUR)</b> |
|--|--|---------------------------------------|
| QQ (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)             | 1 725                                  | 14,7                                  |
| NjQV   | 4 140                                  | 33,4                                  |
| Donatorët (GDC, SDC, EUD+JICA+SIDA)                        | 280                                    | 2,4                                   |
| <b>Totali i financimit të sektorit</b>                     | <b>6 145</b>                           | <b>51,0</b>                           |


#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

Referuar objektivit të vitit 2025 për të arritur në 30% të financimit nga buxheti i brendshëm kundrejt nevojës për financim në nivelin ZMM, mund të thuhet se ka pasur një progres të dukshëm. Ndonëse financimi buxhetor ka qenë për dy investime strategjike për sektorin, rritja në masën 451% (për dy vitet së bashku (2020 dhe 2021, krahasuar me 2019) është e konsiderueshme.

Faktori më i rëndësishëm për sukses në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është qëndrueshmëria e financimit të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve. SKMIM dhe Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta nuk kanë një vlerësim të nevojës së sektorit për MIM, si dhe ndarjen e kostove për çdo zone mbetjesh. Për rrjedhojë, vlerësimi aktual i progresit mund të bëhet

|          |         |       |                     |
|----------|---------|-------|---------------------|
| Pogradec | 80,000  | 684   | 70,616              |
| Berat    | 73,724  | 630   | 76,546              |
| Poliçan  | 73,438  | 628   | 8,000               |
| Fier     | 164,655 | 1,407 | 205,200             |
| Vlorë    | 285,302 | 2,438 | 203,588             |
| Himarë   | 75,000  | 641   | 11030+40000 turiste |

Edhe për vitin 2021, Bashkitë referojnë problematikën e mungesës së fondeve si faktorin kufizues në përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Mungesa e gjenerimit të të ardhura për mbulimn e shërbimit prej tarifës vjen nga një nivel i ulët i tarifës dhe grumbullimi i pjesshëm i saj. Tarifat e raportuara nga bashkitë variojnë ndjeshëm, ndonëse në disa NjQV ka diferencim në tarifë për familjet dhe bizneset. Më poshtë paraqitet paraqitet një ndarje e bashkive sipas vlerave të tarifës mesatare për vitin 2021 (për 60 bashki që kanë paraqitur të dhëna në AKUM):




**Grafiku 7:** Shpërndarja e NjQV lidhur me vlerën e tarifës mesatare për grumbullimin e mbetjeve

Të dhënat e mbledhura lidhur me grumbullimin e tarifës për vitin 2021 janë shumë të ndryshueshme ndërmjet NjQV. Mesatarja e tarifës në nivel vendi del 53.3% kundrejt nevojës, por ka bashki që kanë vlera mjaft të ulta si Krushë, Memaliaj dhe Fushë Arrës (nën 15%), ndërsa disa të tjera paraqesin një performancë më të mirë. Të dhënat e paraqitura bazohen në vetëdeklarimin prej NjQV,

buxhetit vendor për menaxhimin e mbetjeve

Edhe gjatë vitit 2021, cilësia e shërbimit kushtëzohet vetëm prej mbulimit të pamjaftueshëm të kostos së shërbimit minimal për grumbullimin, transportin e mbetjeve dhe pagesën e tarifës së depozitimit në rastet e impjanteve fundore.

Mbulimi i nevojës financiare prej të ardhura të grumbulluara në nivel vendor kundrejt planifikimit paraqitet në grafikun e mëposhtëm, ku mesatarja në nivel vendi është 73%:



Grafiku 9: Shpërndarja e NjQV lidhur me grumbullimin e të ardhurave prej tarifës kundrejt planifikimit për vitin 2021 (sipas pyetësorëve të vlerësimit)

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit


| Treguesit nr. 30-32   | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020                             | Realizimi 2021 | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor |
|---|-----------|----------------|--|----------------|---|-------------------|
| % e buxhetit të alokuar nga bashkitë kundrejt nevojës për financim        | 50%       | 80%            | 71% për Bashkitë që kanë referuar të dhëna | 60-70%         | Progres të pjesshëm                             | ☹️                |
| % e shumës së të ardhurave nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit | 40%       | 80%            | 60%  | 53,3%          | Nuk ka progres                                  | ☹️                |
| % e tarifës së mbledhur kundrejt planifikimit                             | 60%       | 80%            | 69%  | 73%            | Ka progres                                      | 😊                 |




M19. Ministria përgjegjëse për mjedisin propozon llojet e të ardhurave nga taksat për kategori të ndryshme produktesh të tregut shqiptar dhe i përdor këto fonde për të promovuar zvogëlimin e sasisë së mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.

Për këtë masë gjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndonjë nismë për të propozuar ngritjen e një Fondi për Menaxhimin e Mbetjeve me të ardhurat nga taksa të ndryshme produktesh në tregun shqiptar.

Vlerësimi në përbushjen e objektivit

| Treguesi<br>nr. 36   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| MTM koordinon Fondin për Menaxhimin e Mbetjeve, nëpërmjet hartimit të kuadrit ligjor për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit dhe vënien në zbatim të tij | 10%          | 60%               | Asnjë nismë       | Asnjë nismë       | Nuk ka progres   |  |

Raport vlerësimi i ecurisë së zbatimit të SKMIM: Viti 2021

| Treguesi<br>nr. 38  | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020                    | Realizimi<br>2021                 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|---|--------------|-------------------|--------------------------------------|-----------------------------------|--|---|
| % e investimeve në sektor / kundrejt parashikimit vjetor sipas Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Master Planit | 0%           | 50%               | Nuk ka të dhëna për programe të reja | 1 marrveshje për financim të huaj | Progres në vijimin e zbatimit të programeve ekzistuese   |  |

| Treguesi<br>nr. 39   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin<br>2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|---|---|
| Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin | 80           | 200               | ~90               | 66                | Progresi kufizuar   |  |

Rekomandim: Përfshirja e grumbullimit të të dhënave specifike mbi kapacitetet njerëzore dhe kualifikimin e tyre për sektorin, krahas të dhënave për mbetjet.

**M23. Krijohet sistemi i kurrikulës së kualifikimit. Paketa e trajnimit të vazhduar e ofruar prej QKEV dhe ASPA, së bashku me personelin teknik përkatës do të vlerësohen me kredite vjetore për aftësitë e fituara**

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve është tematikë e kurrikulës së kualifikimit në ASPA dhe ofrohet për punonjësit e administratës qendrore dhe vendore.

Gjatë vitit 2021, nuk referohen të dhëna për trajnime specifike në MIM apo për mbetjet e rrezikshme. Gjatë monitorimit për të dy vitet e para të zbatimit të SKMIM, nuk është referuar asnjë kurs trajnimi për këtë çështje.

Disa nga bashkitë referojnë trajnime të kryera prej programeve të asistencës së huaj në tematika specifike, por jo të lidhura me mbetjet e rrezikshme.

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

| Treguesit<br>nr. 40-42.1   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| % e personelit të specializuar që trajnohet në vit   | 50%          | 100%              | 54.5%             | 0                 | Nuk ka progres   |  |
| Nr. Trajnimeve në vit për institucionet publike apo private që gjenerojnë mbetje të rrezikshme | 0            | 4                 | 0                 | 0                 | Nuk ka progres   |  |
| Nr. trajnimeve periodike për kompanitë që trajtojnë mbetjet të rrezikshme                      | 0            | 4                 | Nuk ka të dhëna   | 0                 | Nuk vlerësohet   |  |

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 8: QYTETARËT PËRDORIN DHE RESPEKTOJNË INFRASTRUKTURËN E MBETJEVE DHE BËHEN PJESË E MASAVE PËR PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE TË PLANEVE VENDORE**



**M25. Qytetarët janë të përfshirë dhe konsultohen për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve**

Nga 11 (nga 34 bashki) që janë përgjigjur për vitin 2021 referojnë për organizimin e proceseve të diskutimit me komunitetet vendore për çështjet e planifikimit dhe të menaxhimit të mbetjeve. Informacioni mbetet pjesor dhe kryesisht i lidhur me tematikën e mbajtjes pastër të territorit. Për vitin 2021 nuk referohen më mënyrë specifike konsultime me banorët lidhur me hartimin e PVMIM.

|   |   |
|---|---|
| Bashkitë që raportojnë se procese pjesëmarrëse gjatë hartimit të PVMIM gjatë 2020 | Dibër, Librazhd, Lushnjë, Kolonjë, Kuçovë, Malësi e Madhe, Mat, Pukë, Rrogzhinë, Shkodër, Vlorë |
|---|---|

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit:**

Referuar objektivit të vitit 2025 për të pasur pjesëmarrje publike të plotë, mund të themi se është krijuar kuptimi i drejtë i nevojës për organizimin e proceseve pjesëmarrëse në hartimin e planeve vendore.

| Treguesi nr. 43-44   | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020                                      | Realizimi 2021                          | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor   |
|--|-----------|----------------|---|---|---|---|
| % (numri) i planeve të hartuara me pjesëmarrje komunitare /totalit të planeve të miratuara               | 70%       | 100%           | 5 plane me procese pjesëmarrëse (nga 8 të miratuar) | 12 procese (por informacion i pjesshëm) | Progres i kufizuar                              |  |
| % (numri) i banorëve që ndajnë mbetjet në burim/kundrejt popullsisë së mbuluar me shërbim të diferencuar | 0%        | 30%            | Nuk ka të dhëna                                     | Nuk ka të dhëna                         | Nuk vlerësohet                                  |  |

**Rekomandim:** Gjatë rishikimit të SKMIM të vlerësohet objektivi për treguesin 44 rreth konsultimit të banorëve, i cili mund të jetë më i lartë dhe i monitoruar kundrejt evidencave të mbajtura.

**M26. Bashkitë organizojnë fushata të përvitshme të ndërgjegjësimit “Let’s do It” që nxisin sjellje të përgjegjshme mjedisore për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve**

Edhe për vitin 2021, informacioni i grumbulluar është më i pasur se ai i referuar gjatë vitit 2020. Pjesa më e madhe e bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit të vlerësimit për vitin e dytë (88%) kanë referuar mbi 140 veprimtari të ndryshme pastrimi dhe ndërgjegjësimi me komunitetin dhe shkollat.


**QËLLIMI STRATEGJIK 5: JANË NGRITUR INSTRUMENTAT LIGJORË, INSTITUCIONALË DHE FINANCIARË PËR TË PËRMIRËSUAR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME**

**OBJEKTIVI STRATEGJIK 9: JANË IDENTIFIKUAR TË GJITHA RRYMAT E MBETJEVE TË RREZIKSHME QË JANË PRODHUAR APO PRODHohen NË TERRITORIN E VENDIT NGA SEKTORI PUBLIK DHE AI PRIVAT**

**M28. Hartimi i një sistemi të dhënash për mbetjet e rrezikshme (inventarizimi i mbetjeve të trashëguara nga industritë ekzistuese, nga industritë që gjenerojnë sot mbetje të rrezikshme)**

Gjatë vitit 2021, nga AKM nuk është referuar ndonjë nismë e veçantë lidhur me ka regjistrin e kompanive të cilat prodhojnë, transportojnë apo përpunojnë mbetje të rrezikshme. Në vijim të procedurës së raportimit Kompanitë kanë vijuar raportimin e tyre vjetor në Rregjistrin e e Shkarkimeve dhe të Transferrimit të Ndotjes sipas kushteve të përcaktuara në lejet e mjedisit. Sipas AKM, kompanitë në vendin tonë kanë kapacitete të vogla prodhimi, transporti apo përpunimi të mbetjeve të rrezikshme të cilat janë më poshtë sesa kufiri i përcaktuar për të raportuar sipas Rregjistrit të Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve (RrShTN).

**Vlerësimi në përmbushjen e objektivit**

| Treguesi<br>nr. 48   | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|--|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| % e institucioneve/bizneseve që gjenerojnë mbetje të rrezikshme që informojnë sipas kategorive dhe formatit të mbetjeve, të identifikuar | 30%          | 100%              | Nuk ka ndryshim   | Nuk ka ndryshim   | Nuk ka progres   |  |

**M29. Hartimi i Master Planit për rryma të veçanta mbetjesh përfshirë mbetjet e rrezikshme**

Gjatë 2021, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si ministria përgjegjëse për hartimin e Master Planit përfshirë rryma të veçanta mbetjesh dhe mbetjet e rrezikshme nuk ka referuar ndonjë nismë për fillimin e hartimit të këtij dokumenti strategjik.



kushtet kur nuk ka pasur impjante të reja të futura në operim, tregon mbi probleme me raportimin e të dhënave.

Sipas raportimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021, nga 43 spitalet publike dhe Qendra Kombëtare e Trajtit të Gjakut, sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme të prodhuara gjatë vitit 2021 është 794,532.7 kg. Sipas raportimit nga 14 spitale jo-publike, sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme të prodhuara dhe trajtuara gjatë vitit 2021 është 295,021.68 kg. Sipas raportimit nga 36 Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, sasia e mbetjeve spitalore të rrezikshme të prodhuara dhe trajtuara gjatë vitit 2021 nga Qendrat Shëndetësore është 78,141.73 kg. Sasia totale e raportuar për mbetjet spitalore të rrezikshme të prodhuara gjatë vitit 2021 është 1,167,747.11 kg, ndërsa sasia e trajtuar është 1,160,364.71 ose sa 99.4% e totalit të gjeneruar.



Të dhënat në tabelën e mëposhtme paraqesin sasinë e grumbulluara dhe të trajtuara të mbetjeve të rrezikshme spitalore gjatë vitit 2021, krahasuar me 2020 dhe vitin e referencës 2019.

| Mbetjet spitalore (kg)            | 2019           |                |   | 2020           |                |   | 2021             |                  |   |
|-----------------------------------|----------------|----------------|---|----------------|----------------|---|------------------|------------------|---|
|                                   | Grumbulluar    | Trajtuar       | % e trajtuar ndaj sasisë së grumbulluar | Grumbulluar    | Trajtuar       | % e trajtuar ndaj sasisë së grumbulluar | Grumbulluar      | Trajtuar         | % e trajtuar ndaj sasisë së grumbulluar |
| Institucione shëndetësore publike | 442,119        | 440,119        | 99.5%                                   | 591,469        | 567,313        | 95.9%                                   | 794,533          | 781,42           | 98.4%                                   |
| Spitale private                   | 252,461        | 252,461        | 100.0%                                  | 220,157        | 220,157        | 100.0%                                  | 295,021          | 295,021          | 100%                                    |
| <b>Total (kg)</b>                 | <b>694,580</b> | <b>692,580</b> | <b>99.7%</b>                            | <b>811,626</b> | <b>787,470</b> | <b>97.0%</b>                            | <b>1,167,747</b> | <b>1,160,365</b> | <b>99.4%</b>                            |

#### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

| Treguesit nr. 50-59   | Viti 2019 | Objektivi 2025 | Realizimi 2020  | Realizimi 2021  | Vlerësimi për 2021 krahasuar me objektivin 2025 | Vlerësimi cilësor   |
|---|-----------|----------------|-----------------|-----------------|---|---|
| % e mbetjeve minerare të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar | 0%        | 20%            | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka progres                                  |  |
| % e mbetjeve kimikate të grumbulluara dhe të trajtuara kundrejt totalit të kësaj kategorie të gjeneruar | Nuk ka    | 30%            | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka progres                                  |  |

### Vlerësimi në përmbushjen e objektivit

| Treguesit<br>nr. 60-61  | Viti<br>2019 | Objektivi<br>2025 | Realizimi<br>2020 | Realizimi<br>2021 | Vlerësimi për<br>2021<br>krahasuar me<br>objektivin 2025 | Vlerësimi<br>cilësor  |
|---|--------------|-------------------|-------------------|-------------------|--|---|
| Nr. I kompanive që gjenerojnë dhe trajtojnë mbetje të rrezikshme që raportojnë rregullisht në RrSHTN kundrejt totalit të tyre në vend | 20%          | 100%              | Nuk ka të dhëna   | Nuk ka të dhëna   | Nuk ka progres   |  |
| % e mbetjeve të rrezikshme që ndahen nga mbetjet e parrezikshme   | 1%           | 3%                | Nuk ka të dhëna   | Nuk ka të dhëna   | Nuk ka progres   |  |

## PYETËSOR

### PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

(VITI 2021)

Drejtuar: Bashkisë: \_\_\_\_\_

Kthim përgjigje: Lediana Karalliu, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
lediana.karalliu@turizmi.gov.al

Afati i përgjigjes:

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (SKMIM) dhe Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për periudhën 2020-2035 është miratuar në Maj 2020. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar procesin e monitorimit të zbatimit të këtyre dokumentave strategjikë për vitin e parë 2020, dhe po përgatit vlerësimin vjetor të zbatimit kundrejt treguesve të performancës së miratuar në këtë Strategji dhe Plan Veprimi.

Përmes të dhënave të këtij pyetësori synojmë të vlerësojmë: a) efektivitetin e zbatimit të SKMIM dhe PKV 2020-2035 për vitin e parë 2020; b) efikasitetin e strukturave menaxhuese përgjegjëse për zbatimin e masave specifike; dhe c) të nxirren përfundime dhe rekomandime për të përmirësuar zbatimin e mëtejshëm të këtyre dokumenteve.

MTM dhe Grupi Teknik do të drejtojnë këtë proces me mbështetjen e programit të GIZ për "Modernizimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe riciklimit në Shqipëri

Tiranë, Korrik 2022



5. Sa është % e popullatës në Bashkinë tuaj që mbulohet me shërbimin e integruar të mbetjeve?  
[OS2-M5-7]

---

A ka pasur ndryshim në numrin e banorëve që i është ofruar shërbimi i integruar i mbetjeve gjatë vitit të fundit?

---

6. A ka në territorin e Bashkisë juaj, qytet me më shumë se 100.000 banorë? [OS2-M5-8]

PO  JO

Nëse PO, sa % e popullësisë urbane mbulohet nga shërbimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM).

---

A ka ndryshuar % gjatë vitit të fundit? Tregoni arsyet?

---

7. Sa % e mbetjeve shkojnë (për çdo rrymë) për riciklim, kundrejt sasisë totale të mbetjeve?  
[OS2-M5-9]

---

A ka ndryshuar % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

8. Sa është % e mbetjeve të tjera të rikuperuara nga mbetjet mikse, kundrejt totalit të mbetjeve?  
[OS2-M5-10]

---

Ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

9. Sa është % e mbetjeve të paketimit të rikuperuara nga mbetjet mikse, kundrejt totalit të mbetjeve? [OS2-M5-11]

---

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

15. Nëse i dërgoni mbetjet e pariciklueshme në një impjant WfE, sa është sasia e mbetjeve të dërguara në ËtE në ton mbetje gjatë vitit të fundit? [OS2-M7-17]

---

16. A kryeni grumbullimin e mbetjeve nga paketimet në bazë të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit? [OS2-M8-18]

---

Specifikoni llojin e mbetjeve të grumbulluara:

---

Nëse PO, a ka ndryshim në sasinë e grumbulluar gjatë vitit 2021 dhe cilët faktorë kanë ndikuar?

---

17. Në kuadër të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, a keni hartuar Plane Fizibiliteti për Zonat Mbetjeve, për rryma të veçanta mbetjesh, në qendra të përbashkëta apo të veçanta (për gomat, mbetjet elektrike, organike, makinat në fund të jetës)? [OS3-M9-19]

---

18. Cila është % e baterive dhe akumulatorëve që dërgohen në qendrat e pritjes dhe tërhiqen nga bizneset e licencuara? [OS3-M9-20]

---

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

19. Cila është % e llumrave në impjantet e trajtimit të ujrave të përdorur, që trajtohen pranë tyre? [OS3-M9-21]

---

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

20. Cila është % e mbetjeve inerte që grumbullohen në impjantet e trajtimit dhe ripërdoren?

---

A ka ndryshuar kjo % gjatë vitit 2021? Tregoni arsyet pse?

---

21. Në kuadër të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, a ka skema funksionale për rikuperimin dhe trajtimin e mbetjeve specifike? [OS3-M11-24]

PO       JO

Nëse PO, tregoni vitin kur keni filluar dërgimin e këtyre mbetjeve?

---

29. A ka njësi të specializuar për menaxhimin e mbetjeve pranë Bashkisë suaj? [OS7-M22-39]

PO  JO

Sa është numri i personelit të kualifikuar për këtë detyrë në institucion?

---

30. A ka pasur personel të kualifikuar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve gjatë vitit 2021? [OS7-M23-40]

PO  JO

Nëse Po, sa ka qenë numri i personave të kualifikuar?

---

31. A keni Plan të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të hartuar me pjesëmarrje qytetare? [OS8-M25-43]

PO  JO

Nëse Po, a është hartuar gjatë 2021?

---

32. A ndahen mbetjet në burim në Bashkinë tuaj? [OS8-M25-44]

PO  JO

Nëse PO, sa është numri i banorëve që kanë ndarë mbetjet në burim gjatë 2021?

---

33. A keni organizuar veprimtari ndërgjegjësimi dhe pastrimi në Bashkinë tuaj gjatë vitit 2021? [OS8-M26-45]

PO  JO

Nëse po sa aktivitete të tilla, përshkruani ku dhe sa banorë kanë përfituar.

---

A ka pasur ndryshim në numrin e veprimtarive në vitin e fundit?

---

34. Sa është numri i shkollave në Bashkinë tuaj që kanë zhvilluar një kurrikul të edukimit mjedisor gjatë vitit 2021? [OS8-M27-46]

---

Nëse mund të jepni të dhëna për nivelin ku zhvillohet ky program mesimor (AMU, AML) dhe numrin e përafërt të nxënësve.

---